



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Primerat / Originals		13 . 12 8 vit / post / year	
Organizata / Organization	Skema / Scheme	Procedura / Procedure	Shuma / Quantity
SKPMSHCK	7669/2018		111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 320 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Doganën e Kosovës, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Doganën e Kosovës.
2. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Doganën e Kosovës, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm në Doganën e Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Doganën e Kosovës dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dated Received / Prezado Received / Dated	13 - 12	8	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	SKPM SHHC	7669 / 2018	1111



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA

INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORT I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE

PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

DOGANAT E KOSOVËS

PËR VITIN

2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	03
Funksioni i mbikëqyrjes.....	03
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	03
Fushat e mbikëqyrjes.....	04
Raporti për mbikëqyrjen në Doganat e Kosovës.....	05
Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve.....	06
Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit.....	07
Procedurat disiplinore.....	07
Procedurat e ankesave.....	07
Procedurat e vlerësimit.....	08
Procedurat e pushimeve.....	08
Procedurat e transferimit.....	08
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara.....	09
Pezullimi, ndërprerja dhe përfundimi i marrëdhënies së punës.....	09
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	09
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	10
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	10
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	10
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	10
Shënimet/komentet për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	11

HYRJJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI I KËSHILLIT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar „Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton „Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim të vitit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë, duke u bazuar në „Pyetësin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil” kemi kryer monitorimin duke zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit për shërbimin civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë zbatimit të mandatit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të institucioneve, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil.

Në këtë kuadër, si pjesë e mbikëqyrjes janë përfshirë fushat:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

**RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE
PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL
NË DOGANAT E KOSOVËS PËR VITIN 2017**

Kolegji gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Doganat e Kosovës, për të vlerësuar drejtë, në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Doganat e Kosovës, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës me datë 22.02.2018, në prezencë të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një numër të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Evidencën e pushimeve mjekësore të vitit 2017;
- Vendimin mbi pushimin e lehonisë të datës 25.10.2016;
- Vendimin e pushimit të lehonisë të datës 02.08.2017;
- Plani vjetor i trajnimeve i nëpunësve civil janar 2017 deri me dhjetor 2017;
- Vendimi për suspendim i datës 23.01.2015;
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 18.01.2017;
- Raporti i datës 06.12.2017 për listën e shkurtër për pozitën përkthyes;
- Vendimi i datës 09.10.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës;
- Vendimi i datës 11.10.2017 për kompensimin e një page mujore me rastin e vdekjes së nëpunësit;
- Vendimi i datës 14.10.2013 për avancim;
- Akt emërimi i datës 01.11.2011 i nëpunëses në zyrën administrative;
- Formular i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2017;
- Vendimin për formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, të datës 28.06.2017;
- Vërejtja me shkrim e datës 30.12.2016;
- Vendimi për pezullim i datës 08.05.2017;
- Vendimin për formimin e Komisionit Disiplinor, i datës 28.06.2017;
- Vendimi për emërim të përkohshëm UD i Udhëheqësit të sektorit të mallrave të sekuestruara i datës 24.03.2017;
- Vendimi për emërimin e UD e zyrtarit certifikues i datës 24.03.2017;
- Vendimi për emërimin e UD Udhëheqës i sektorit të buxhetit i datës 24.03.2017;
- Vendimi për emërimin e UD Udhëheqës i sektorit të hyrave i datës 24.03.2017;
- Vendimi për përfundimin e punësimit-dorëheqje e datës 29.03.2017;
- Vendimi për përfundim të punësimit-dorëheqje e datës 20.01.2017;
- Formular i vlerësimit i datës 23.02.2018;
- Lista e punëtorëve të doganës e datës 30.11.2017;
- Lista e pagave për muajin nëntor të vitit 2017;
- Udhëzimi administrativ Nr. 41/2017;
- Plotësim ndryshimi i shtojcës 2 të Udhëzimit administrativ Nr. 39/2017 për strukturën organizative të Doganës së Kosovës;
- Organogrami i Doganës së Kosovës;
- Shtojca 2 e udhëzimit administrativ me Nr. 39/2017 për strukturën organizative të Doganës së Kosovës;
- Plani i trajnimeve për nëpunësit civil i datës 16.01.2017;
- Vendimi i Komisionit të Ankesave i datës 20.11.2017;
- Vendimi i Komisionit të Ankesave i datës 12.12.2017;

- Vendimi i Komisionit të Ankesave i datës 20.11.2017;
- Vendimi i Komisionit të Ankesave i datës 12.01.2018;
- Vendimi për transferim të përkohshëm i datës 30.08.2017 dhe
- Vendimi për transferim të përkohshëm i datës 24.07.2017.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në pyetësin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar të gjeturat në vijim të raportit, si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të Doganave të Kosovës, si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Doganat e Kosovës me datë 22.02.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr. 39/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Doganat e Kosovës.

Sipas informatave të zyrtarëve të personelit, në këtë institucion janë të punësuar 84 nëpunës civil, ndërsa numri i pozitive të lira është nëntë (9).

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve për ushtruesit e detyrës, gjegjësisht Vendimit për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën „Udhëheqës i sektorit të mallrave të sekuestruara” „zyrtar certifikues” „Udhëheqës i sektorit të buxhetit” dhe „Udhëheqës i sektorit të hyrave” ka konstatuar që për këto raste nuk janë respektuar procedurat ligjore për caktimin e ushtruesit të detyrës.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me Vendimin me numër 06.3 të datës 24.03.2017 është caktuar ushtrues i detyrës „Udhëheqës i sektorit të mallrave të sekuestruara”, nëpunësi civil nga pozita „udhëheqës i njësitit të transportit, nga data 03.04.2017 dhe e ka ushtruar këtë detyrë deri me datë 01.01.2018.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me Vendimin me numër 06.3, dhe numër protokoli 01/86/2017 të datës 24.03.2017 është caktuar ushtrues i detyrës „Zyrtar Certifikues”, nëpunësi civil nga pozita „udhëheqës i njësitit të buxhetit” nga data 03.04.2017 dhe ka qenë duke e ushtruar këtë detyrë deri në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me Vendimin me numër 06.3, dhe numër protokoli 01/85/2017 të datës 24.03.2017 është caktuar ushtrues i detyrës „Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit”, nëpunësi civil nga pozita „udhëheqës i njësitit të buxhetit” nga data 03.04.2017 dhe ka qenë duke e ushtruar këtë detyrë deri në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me Vendimin me numër 06.3, dhe numër protokoli 01/87/2017 të datës 24.03.2017 është caktuar ushtrues i detyrës „Udhëheqës i Sektorit të Hyrave”, nëpunësi civil nga pozita „udhëheqës i njësitit të buxhetit” nga data 03.04.2017 dhe ka qenë duke e ushtruar këtë detyrë deri në ditën e monitorimit.

Me këtë veprim Dogana e Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e nenit 37 paragrafit 4 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohor për ushtruesin e detyrës si dhe për nëpunësin zëvendësues.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Kosovës që të ndërmarr të gjitha veprimet e duhura për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe për zbatimin e dispozitave ligjore të nenit 30 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e nenit 36 dhe 37 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, për pozitat e lartcekura si dhe për çdo rast të caktimit të ushtruesit të detyrës apo të zëvendësimit të nëpunësit civil.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Dogana e Kosovës, gjatë vitit 2017 ka zhvilluar gjithsejtë katër (4) procedura të rekrutimit të jashtme dhe një (1) procedurë e rekrutimit të brendshëm, prej të cilave dy (2) procedura janë anuluar.

Sipas deklarimit të zyrtarit përgjegjës të personelit, nuk ka pasur marrëveshje për shërbime të veçanta për pozitat e nëpunësve civil.

Për këtë fushë të mbikqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të Vendimit të datës 28.06.2017 për emërimin e Komisionit Disiplinor, ka konstatuar se Dogana e Kosovës, Komisionin Disiplinor e ka themeluar në pajtim me dispozitat e nenit 70 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në këtë institucion ka pasur dy procedura disiplinore ndaj nëpunësve civil.

Për këtë fushë të mbikqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të Vendimit të datës 28.06.2017 për emërimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ka konstatuar se Dogana e Kosovës, e ka themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave janë parashtruar dhjetë (10) ankesa, prej tyre gjashtë (6) ankesa janë trajtuar në Këshill, ndërsa katër ankues janë pajtuar me vendimet e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Doganave të Kosovës, sepse nuk kanë parashtruar ankesa në Këshill.

Për këtë fushë të mbikqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Doganat e Kosovës, kemi vetëm një nëpunës civil të cilës nuk i është bërë vlerësimi i punës për vitin 2017. Arsyetimi nga përgjegjësit e organit të punësimit, ishin se e njëjta nëpunëse ka qenë në pushim të lindjes deri me datë 13.10.2017, nga kjo datë e njëjta ka shfrytëzuar pushimin vjetor të vitit 2016, ku pas verifikimit në dosjen e nëpunëses civile gjendet kërkesa e aprovuar e pushimit vjetor si dhe shenjat e shfrytëzimit pushimit mjekësor, kështu që nuk i është bërë vlerësimi i punës për vitin 2017 sepse ka pasur shumë pak ditë pune gjatë vitit 2017.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil gjegjësisht të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë, zyrtarët përgjegjës janë të obliguar që të vlerësojnë të gjithë nëpunësit civil, e në raste të caktuara të përcaktojnë edhe kohën e vlerësimit, nëse nëpunësi ka qenë në pushim mjekësor, të lehonisë apo pushim pa pagesë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Kosovës dhe udhëheqësin e personelit që të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore për vlerësimin e të gjithë nëpunësve civilë në pajtim me procedurën dhe afatet e përcaktuara me Rregulloren Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në evidenca e pushimeve të nëpunësve civil mbahet vetëm në versionin elektronik.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Doganat e Kosovës, evidenca e pushimeve të nëpunësve civil mbahet në versionin elektronik. Nëpunësit civil kanë realizuar pushimin mjekësor në 79 raste, dhe në bazë të dosjeve të kontrolluara, konstatohet që nëpunësit civil i kanë sjell dëshmitë mjekësore ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Kolegji ka konstatuar se dy (2) nëpunëse civile kanë realizuar pushim të lehonisë, dhe në bazë të Vendimeve për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë, pushimi është miratuar në pajtim me legjislacionin përkatës për pushimin e lehonisë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Doganat e Kosovës, ka pasur tri (3) transferime, prej tyre dy (2) transferime të përkohshme dhe një (1) transferim i përhershëm të nëpunësve civil, prej të cilave të tri transferimet kanë qenë të brendshme, dy rastet e transferimeve të përkohshme janë shqyrtuar me ankesë në Këshill, njëra ankesë është refuzuar, ndërsa njëra ankesë është kthyer në rishqyrtim tek organi i punësimit.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Dogana e Kosovës, nga numri i përgjithshëm i nëpunësve civil, ka pasur të punësuar 75 nëpunës civilë, dhe prej tyre 69 nëpunës janë shqiptar dhe gjashtë (6) nëpunës të përkatësisë etnike serbe.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se nga numri i përgjithshëm i nëpunësve civil, Dogana e Kosovës ka pasur të punësuar 75 nëpunës civilë, dhe prej tyre 48 nëpunës civilë prej tyre janë meshkuj, ndërsa vetëm 27 nëpunëse janë femra, që nënkupton se nuk ka numër të të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Kosovës, që të ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Doganat e Kosovës, kanë pas një rast të transferimit të përhershëm dhe dy raste të transferimit të përkohshëm, një rast të suspendimit nga puna që nga viti 2015 e që vazhdon akoma, dhe një rast të pezullim të ushtrimit të detyrave dhe ndalimi i 1/3 e rrogës për një periudhë një (1) mujore, (rast ky i shqyrtuar me ankesë të cilit i është refuzuar ankesa), po ashtu kanë pasur dy raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës me dorëheqje të nëpunësve civil dhe një rast të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës, me vdekjen e nëpunësit civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të informatave të pranuar nga zyrtarët e personelit, ka konstatuar se në Doganat e Kosovës, nuk ka pasur asnjë nëpunës civil i cili është duke e mbajtur pozitën e nëpunësit civil dhe në të njëjtën kohë është duke e ushtruar detyrën e funksionarit publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Dogana të Kosovës gjatë vitit 2017 nuk ka asnjë nëpunës ndaj të cilit është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ose është dënuar me vendim të gjykatës, vetëm një rast (suspendimit nga puna që nga viti 2015).

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, sipas deklarimeve të udhëheqëses së personelit, ka konstatuar se në Doganat e Kosovës, Plani i trajnimeve, është përgatitur dhe është proceduar në DASHC/MAP.

Në bazë të dëshmive të ofruara, konstatohet që 45 nëpunës civil kanë marr pjesë në trajnime në bazë të ftesave nga IKAP, ndërsa gjatë vitit 2017 nëpunësit civil nuk kanë marr pjesë në trajnime jashtë vendit. Evidenca e trajnimeve të nëpunësve civilë mbahet në formë elektronike.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Dogana të Kosovës, evidenca e vijimit në punë mbahet në formë elektronike. Shtesa të cilat realizohen janë shtesa për rrezikshmëri në punë, për IT si dhe për punë jashtë orarit. Pagat e nëpunësve civilë janë në pajtim me akt emërimet.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Dogana e Kosovës, është monitoruar në vitin 2017 dhe si rrjedhojë ka pasur tetë rekomandime për këtë institucion, prej tyre ka zbatuar katër rekomandime.

Lidhur me Vendimet e Këshillit, është konstatuar që Dogana e Kosovës, nuk ka pasur obligim për të zbatuar asnjë vendim të Këshillit.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikqyrjes për vitin 2017 në Doganat e Kosovës, ka konstatuar tri (3) të gjetura dhe ka dhënë tri (3) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Doganave të Kosovës, që **të gjeturat dhe rekomandimet** e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lulzim ALIAJ
Kryetar i Kolegjit

Zyle GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Raporti i dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës së Kosovës;
- Menaxherit të Personelit të Doganës së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.